

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-169/14

**Prishtinë,
20 korrik 2016**

Në çështjen juridike të:

K.Sh.

Fshati Bec

Komuna e Gjakovës

Pala ankuese

kundër

Z.O. si perfaqes i M.O.

Rr. "Juliane Ćatić", Nr. 29

Kragujevac

Republika e Serbisë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/219/2013 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat: KPA19193 dhe KPA19194) të datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 20 korrik 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga K.Sh. , të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-169/2014 dhe GSK-KPA-A-170/2014, bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-169/2014.
2. Refuzohen si të pabazuara ankesat e paraqitura nga K.Sh. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/219/2013, të datës 27 nëntor 2013, sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP me numrat KPA19193 dhe KPA19194.
3. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/219/2013 i datës 27 nëntor 2013, sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP me numrat KPA19193 dhe KPA19194.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 24 nëntor 2006, M.O. (më tutje “pala përgjegjëse në ankesë”), duke vepruar në emër të nënës së tij Z.O. , ka paraqitur dy kërkesa të ndara në Agjencinë Kosovare të Pronës (më tutje “AKP”), të regjistruara nën numrat KPA19193 dhe KPA19194, duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe ri-posedimin mbi ngastrën nr. 1218/3 (KPA19193) dhe ngastrën nr. 1194/1 (KPA19194), të cilat ndodhen te vendi i quajtur Ravnica/Bec, Komuna e Gjakovës (më tutje “pronat e kërkuara”). Për më tepër, pala përgjegjëse në ankesë kërkon kompensim për shfrytëzimin e provave të tija pa lejen e tij.
2. Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se pronat e kërkuara ishin humbur për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë në vitet 1998/99, duke e cekur 12 qershorin 1999 si datën e humbjes. Sipas M.O. it, pronat e kërkuara tani janë të uzurpuara nga familja Sh. .
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala përgjegjëse në ankesë në AKP i dorëzoi këto dokumente:

- Kopjen e Ekstraktit të Fletës Poseduese, të lëshuar nga Qendra për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Gjakovës më 5 tetor 1994, ku ceket se nëna e palës përgjegjëse në ankesë i posedonte ngastrat e tokës me numrat 1218/3, 1194/1 dhe 1197.
 - Kopjen e Çertifikatës së Lindjes të palës përgjegjëse në ankesë nr. 200-3852/04-VII të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Gjakovës më 6 korrik 2004.
 - Kopjen e Autorizimit të dhënë nga Z. Z.O. djalit të saj për ta përfaqësuar atë në procedurën para Agjencisë Kosovare të Pronës. Nënshkrimi i Z.O. është legalizuar nga Gjykata Komunale e Kragujevacit më 6 shtator 2007 (Ov.10929/07).
4. Njoftimi fillestar i kërkesës u bë më 3 dhjetor 2007 që i tregonte pronat si livadhe, jo të uzurpuara.
 5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së i verifikoi pozitivisht certifikatën e lindjes të palës përgjegjëse në ankesë si dhe Fletën Poseduese nr. 206, që i liston pronat e kërkuara nën emrin e nënës së palës përgjegjëse në ankesë.
 6. Më 22 shkurt 2008, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/8/2008 i aprovoi kërkesat duke e konstatuar të drejtën e pronësisë së nënës së palës përgjegjëse në ankesë mbi pronat e kërkuara.
 7. Me Vendimin e saj KPCC/RES/19/2010 të marrë më 12 maj 2010, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e informoi Komisionin për Kërkesa Pronësore të Kosovës se kërkesat nuk ishin proceduar si duhet; gjegjësisht, pronat e kërkuara nuk janë identifikuar si duhet fizikisht dhe kërkesat nuk ishin njoftuar. Prandaj, kërkesat i janë kthyer prapa Sekretarisë Ekzekutive për njoftim të mirëfilltë të tyre.
 8. Më pas, njoftimi i kërkesave është bërë më 22 nëntor 2010 dhe pronat e kërkuara u gjetën të uzurpuara nga K.Sh. (më tutje “pala ankuese”), i cili ishte i pranishëm në pronë. Ai e nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes duke pretenduar të drejtë ligjore mbi pronat.
 9. Më 11 qershor 2013, K.Sh. (më tutje “pala ankuese”) paraqiti një përgjigje ndaj kërkesës. Pala ankuese pretendoi se që nga viti 1930 pronar i pronës së kërkuar ka qenë gjyshi i tij Q.

Sh. , por gjatë kohës së komunizmit (1962), “Kombinati Ereniku” e ka marrë ngastrën e tokës nga familja e tij me dhunë dhe pa kompensim. Gjatë periudhës së masave të dhunshme (1989 – 1990), familja e tij ishte e obliguar që të paguajë qira për shfrytëzimin e pronave të kërkuara dhe kjo situatë zgjati deri në vitin 1998, kur filloi lufta. Pas luftës, familja e tij vazhdoi me shfrytëzimin e tokës. Megjithatë, familja Sh. , sipas palës ankuese, e kishte shfrytëzuar pronën e kërkuar derisa ajo iu dha familjes O., pasi që në atë kohë M.O. ishte kryetar i komunës.

10. Për t’i mbështetur pretendimet e veta, pala ankuese dorëzoi *inter alia*:

- Kopjen e Çertifikatës së “Historisë” nr. 952-06-30/13 të lëshuar nga Departamenti i Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës të Komunës së Gjakovës më 6 qershor 2013, që shpjegon se në vitin 1994 në bazë të Aktgjykimit nr.388/93 dhe ujdisë gjyqësore nr. 15/94, nëna e palës përgjegjëse në ankesë kishte hyrë në posedim të ngastrës së tokës nr. 1218/3. Sipas kësaj çertifikate, ngastra e tokës nr. 1198 ishte ndarë dhe ishte formuar ngastra e tokës nr.1218/3 me sipërfaqe prej 0.12.49 ha.
- Kopjet e Kontratave të qirasë të lidhur më 13 shkurt 1995 ndërmjet PKB Primarna Proizvodnja” Sh.P.K në Gjakovë si qiramarrës dhe K.Sh. t si qiradhënës. Në bazë të Kontratës, ngastra e tokës nr.1218 me sipërfaqe prej 2.20.03 ha ishte objekt i qirasë deri në fund të të korrave në vitin 1995.
- Kopjen e Faturës nr. 6 që konfirmon pagesën e shumës së qirasë në vlerë prej 484,06 dinarë nga K.Sh. .
- Kopjen e Kontratës së qirasë të lidhur më 8 mars 1993 ndërmjet PKB Primarna Proizvodnja” Sh.P.K në Gjakovë si qiramarrës dhe K.Sh. t si qiradhënës. Në bazë të Kontratës, ngastra e tokës nr.1218 me sipërfaqe prej 2.20.03 ha ishte objekt i qirasë deri në fund të të korrave në vitin 1993.
- Kopjen e Faturës nr. 23 që konfirmon pagesën e shumës së qirasë në vlerë prej 484,060 dinarë nga K.Sh. .
- Kopjen e Kontratës së Qirasë të lidhur më 13 prill 1994 ndërmjet PKB Primarna Proizvodnja” Sh.P.K në Gjakovë si qiramarrës dhe K.Sh. t si qiradhënës. Në bazë të Kontratës, ngastra e tokës nr. 1218 me sipërfaqe prej 2.20.03 ha ishte objekt i qirasë deri në fund të të korrave në vitin 1994.

- Kopjen e Faturës nr. 65 që konfirmon pagesën e shumës së qirasë në vlerë prej 330,05 dinarë nga K.Sh. .
 - Kopjen e Kontratës së qirasë të lidhur më 11 mars 1996 ndërmjet PKB Primarna Proizvodnja” Sh.P.K në Gjakovë si qiramarrës dhe K.Sh. t si qiradhënës. Në bazë të Kontratës, ngastra e tokës nr.1218 me sipërfaqe prej 2.20.03 ha ishte objekt i qirasë deri në fund të të korrave në vitin 1996.
 - Kopjen e Faturës nr. 19 që konfirmon pagesën e shumës së qirasë në vlerë prej 880,12 Dinarë nga K.Sh. më 11.03.1996.
 - Kopjen e Faturës nr. 41 që konfirmon pagesën e shumës së qirasë në vlerë prej 1.100,15 Dinarë nga K.Sh. më 31.03.1997.
11. Më 27 nëntor 2013, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/219/2013 konstatoi së nëna e palës përgjegjëse në ankesë është pronare e pronave të kërkuara dhe urdhëroi që ajo kishte të drejtën që ta posedonte atë.
12. Vendimi i KKPK-së iu dorëzua palës ankuese më 25 prill 2014, ndërsa ai paraqiti ankesë më 7 maj 2014.
13. Ankesa iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 24 mars 2014. Ai u përgjigj ndaj ankesës më 29 shtator 2014.

Pretendimet e palëve

Pala ankuese

14. Pala ankuese deklaron se Vendimi i KKPK-së përmban gabim thelbësor, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe mbështetet në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike. Sipas palës ankuese, jo të gjitha faktet e paraqitura janë “vlerësuar në mënyrë të barabartë”, pasi që gjatë procedurës ai kishte deklaruar se pronat e kërkuara ishin shfrytëzuar nga paraardhësi i tij dhe ai vetë që nga viti 1976, dhe se shfrytëzimi ishte paraprirë nga një marrëveshje për shfrytëzim dhe si të tilla ai i ka poseduar. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka paraqitur prova se ai apo familja e tij kanë hyrë në posedim faktik të pronave të kërkuara. Prandaj, pala ankuese ka kërkuar që Kërkesa të refuzohet si e pabazuar apo të hidhet poshtë për shkak të mungesës së juridiksionit.

15. Së bashku me ankesën ai dorëzoi:

- Kopjen e kërkesës drejtuar Kuvendit Komunal të Gjakovës, Drejtoratit për Pronë dhe Çështje Ligjore më 8 prill 1994 nga KBI "Ereniku" për aprovim lidhur me shkëmbimin e pronës. Sipas kësaj kërkesë, Sh. Q. Sh. , si pronar i ngastrave me numrat 4173/1, 4173/3 dhe 4175 kishte kërkuar shkëmbimin e ngastrave të cekura me ngastrën nr.1187 dhe pjesën e ngastrës nr. 1194/1, pronar i së cilës ishte KBI "Ereniku". Meqë kërkesa ishte aprovuar nga KBI "Ereniku", nga Drejtorati për Pronë dhe Çështje Ligjore të Kuvendit Komunal të Gjakovës ishte kërkuar që ta jep pëlqimin dhe ta aprovojë kërkesën e njëjtë.
- Kopjen e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor në lëndën nr. 910/03 për konfirmimin e të drejtës së pronësisë të paraqitur nga pala ankuese, të hartuar më 15 shtator 2010 nga Gjykata Komunale e Gjakovës nga i cili shihet se procedura është pezulluar deri në marrjen e vendimit të plotfuqishëm nga Agjencia Kosovare e Pronës.

Pala përgjegjëse në ankesë

16. Pala përgjegjëse në ankesë i mohoi pretendimet e palës ankuese dhe kërkoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar. Ai i dorëzoi dokumentet që sipas mendimit të tij vërtetojnë se nëna e tij ka qenë pronare e pronave të kërkuara.

17. Së bashku me përgjigjen, pala përgjegjëse në ankesë paraqiti *inter alia*:

- Kopjen e Aktvendimit të lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjakovës më 14 prill 1998, me të cilën gjykata e kishte refuzuar kërkesën e K.Sh. t të paraqitur kundër Z.O. it për rikthimin e posedimit të ngastrës së tokës nr.1194/1 me sipërfaqe 1.70 ha.
- Kopjen e procesverbalit të hartuar gjatë seancës së Gjykatës Komunale të Gjakovës më 4 tetor 1994 në lëndën I.Br. 15/94 gjatë së cilës palët: debitori “PKB Primarna Proizvodnja DOO” dhe Z.O. kishin hyrë në një marrëveshje dhe vendosën që ngastrat e tokës nr.306/13 dhe 306/47, të cilat ishin përmendur në Aktgjykimin e marrë në lëndën P.Br.388/93 më 26 qershor 1994 do të shkëmbehen me ngastrën e tokës nr.1194/1, 1197 dhe pjesën e ngastrës së tokës nr. 1218/1, të gjitha të listuara

në emër të debitorit dhe do t'i dorëzohen në posedim dhe pronësi të kreditorit (nëna e palës përgjegjëse në ankesë).

- Kopjen e procesverbalit të hartuar nga Gjykata Komunale e Gjakovës më 15 maj 1997 lidhur me ekzekutimin e aktvendimit për përmbarrim I 436/97 në lëndën e kreditorit (nëna e palës përgjegjëse në ankesë) kundër debitorit “PKB Primarna Proizvodnja DOO”.

Arsyetimi ligjor

Bashkimi i ankesave

18. Në përputhje me nenin 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Gjykata Supreme e Kosovës mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrira kur për bashkimin apo shkrirjen e tillë është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a). Ky nen i lejon Komisionit që ta merr parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve, kur baza ligjore dhe çështjet e vërtetimit të provave janë të përbashkëta.
19. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore (Ligji nr. 03/L006) – të zbatueshme drejtpërsëdrejti në procedurën para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 – në nenin 408.1 e lexuar me nenin 193, parashohin mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes një Aktvendimi nëse kjo do ta siguronte efektshmërinë e gjykatës dhe efikasitetin e lëndës.
20. Sikurse duket nga tekstet e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën ankesa përkatëse është paraqitur, faktet, baza ligjore dhe çështjet e vërtetimit të provave janë tërësisht të njëjta në të dy lëndët. Vetëm ngastrat e tokës, që janë objekt i së drejtës pronësore që pretendohet në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në të njëjtën deklaratë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjtë.

21. Prandaj, Gjykata Supreme vendos që ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-169/14 dhe GSK-KPA-A-170/14, të bashkohen në një lëndë të vetme dhe do të procedohet me numrin GSK-KPA-A-169/14.

Meritat

22. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të parashtresave të palëve, të provave të mbledhura në shkresat e lëndës, vendimit të ankimuar dhe pretendimeve të palës ankuese, konsideron se ankesa është e pabazuar.

23. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetence që t'i zgjidh kërkesat që ndërlidhen me konfliktin të cilat përfshijnë rrethana që drejtpërdrejtë ndërlidhen me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Prandaj, paraqitësi i kërkesës duhet ta ofrojë jo vetëm titullarin e pronësisë mbi një pronë të paluajtshme private por gjithashtu të dëshmojë se ai apo ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak rrethanave që drejtpërdrejtë ndërlidhen me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur.

24. Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se e kishte humbur posedimin mbi pronat e kërkuara më 12 qershor 1999, si rezultat i rrethanave në vitet 1998/1999 në Kosovë. Në anën tjetër, pala ankuese pretendoi se ai dhe familja e tij i kishin poseduar pronat e kërkuara para konfliktit dhe se KKPK-ja nuk kishte juridiksion për të vendosur rreth Kërkesave, pasi që pala përgjegjëse në ankesë nuk e kishte poseduar pronën para konfliktit.

25. Provat e paraqitura para KKPK-së tregojnë se nëna e palës përgjegjëse në ankesë i kishte fituar të drejtat e pronësisë dhe posedimin e pronës së kërkuar në bazë të ujdisë gjyqësore I.Br. 15/94 dhe procedurës përmbartimore. Për më tepër, prona e kërkuar ishte e regjistruar në emër të Z.O. . Një analizë e plotë e shtojcave të dorëzuara me deklaratat e tyre çon në konkludimin se pretendimet e palës ankuese se pala përgjegjëse në ankesë dhe nëna e tij kurrë nuk kishin hyrë në posedim të pronës së kërkuar janë në kundërshtim me dokumentet e mbledhura në shkresat e lëndës. Vendimi i marrë nga Gjykata Komunale e Gjakovës më 14 prill 1998, me të cilin gjykata e refuzoi kërkesën e K.Sh. t të paraqitur kundër Z.O. it për rikthimin e posedimit të ngastrës së tokës nr. 1194/1 me sipërfaqe prej 1.70 ha i konfirmon

rrethanat se nëna e palës përgjegjëse në ankesë kishte hyrë në posedim të pronës së kërkuar, pasi që pala ankuese kishte paraqitur një kërkesë në gjykatë duke kërkuar që t'i rikthehet posedimi i tokës. Për më tepër, arsyetimi i aktvendimit drejtpërdrejtë e përmend se në cilën mënyrë nëna e palës përgjegjëse në ankesë kishte hyrë në posedim të pronës së kërkuar dhe po ashtu se marrëveshja gjyqësore më pas ishte ekzekutuar dhe ujdia ishte zbatuar më 15 maj 1997. Këto elemente qartë tregojnë se në të vërtetë Z.O. kishte hyrë në posedim të pronës së kërkuar dhe se pala ankuese ka qenë mirë në dijeni për këtë fakt.

26. Për më tepër, duhet të theksohet se nëna e palës përgjegjëse në ankesë është regjistruar si bartëse e të drejtës pronësore mbi pronat e kërkuara.
27. Në anën tjetër, duhet të ceket se provat e paraqitura nga pala ankuese nuk ndërlidhen me rrethanat e përmendura nga pala përgjegjëse në ankesë. Si rrjedhojë, nuk është dëshmuar rrethana se pala ankuese gjoja ka qenë pronar dhe në posedim të pronës së kërkuar gjatë konfliktit, pasi që dokumentet që ai i ka dorëzuar kanë të bëjnë me periudhën shumë kohë para konfliktit dhe dokumentet e dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë e mbulojnë periudhën pak para konfliktit të viteve 1998/1999.
28. Gjykata Supreme konsideron se kërkesa ndërlidhet drejtpërsëdrejti me konfliktin. Kjo sepse pala përgjegjëse në ankesa ka deklaruar se humbja e pronës së kërkuar ka ndodhur për shkak të konfliktit të armatosur, ndërsa pala ankuese nuk e ka dëshmuar të kundërtën. Pala ankuese megjithatë nuk ka qenë e suksesshme që ta dëshmojë posedimin e tij drejtpërdrejtë para konfliktit.
29. Lidhur me kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë për kompensimin e shfrytëzimit të pronës pa pëlqimin e tij, sipas Ligjit nr. 03/L-079 as Komisioni e as Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme nuk ka juridiksion mbi atë kërkesë.
30. Gjykata Supreme konstaton se KKPJ-ja ka marrë vendim të drejtë, të bazuar në procedurë të plotë dhe korrekte. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim të mangët të fakteve. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar dhe prandaj duhet të vërtetohet Vendimi i ankimuar.

31. Duke i pasur parasysh të lartcekurat, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Këshillë ligjore

32. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky Aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it